

VENDIM
Nr.900, datë 6.12.2011

**PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE PËR SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32 pika 1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në qarqet e Tiranës, të Elbasanit, të Shkodrës, të Durrësit, të Korçës, të Beratit, të Kukësit, të Dibrës, të Vlorës dhe të Gjirokastrës.

Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 43 196.1 (dyzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë një) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme 410 676 127 (katërqind e dhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë.

2. Vlera e përgjithshme për shpërblimin të përballohet nga fondi i kompensimit të pronave, të parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës", të ndryshuar dhe ligji nr.10 239, datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave".

3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar, në pronësi të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha